

STATUTI DHE AKTI THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR VENTEXUS

Ne Durres, sot ne date 21 Janar 2025, me cilesine e ortakut:

1. Z. Enea Dervishi, i datëlindjes 19.05.1995, banuese ne Durres, rruga "Asti Gogoli" shtetase shqiptar, madhor dhe me zotësi te plote juridike e për te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 038789436 dhe me nr. Personal J50519013R.

me vullnet të lire, të plote dhe të singerte, ka hartuar këtë statut te Shoqerise "**VENTEXUS**" shpk , ne respekt dhe bazuar:

- Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi;
- Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare ";
- Ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ";
- Ne legjislacionin Fiskal e Tatimor;

ka themeluar nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "**VENTEXUS**".

Neni 1 Emertimi

Shoqeria gezon emerin **VENTEXUS shpk** dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2 Selia

Shoqeria e ka seline ne Durres, Lagjia nr. 4, Rruga Skenderbej, nr pasurie 4/33+2-7, Zona Kadastrale 8514, Durres. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, me kerkese te administratorit ose me vendim te Ortakeve.

Neni 3 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes se asamblesë se Ortakeve te Shoqërisë.

Neni 4 Objekti i veprimtarise



Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

Ofrimin e te gjitha sherbimeve qe lidhen me "Call Center" dhe Contact Center duke perfshire edhe perpunimin e te dhenave te shoqerive te tjera dhe/ose enteve publike, ndermjetesim tregtare dhe marketing ne fushen e sherbimeve telematike dhe telefonike, veprimtarite e lidhura dhe te ngjashme me ato te renditura me siper, te blej, te shesi, te marri hua, te japi me qira te mira te tundeshme e te patundeshme dhe çdo gje tjeter te nevojshme e te vlefshme per realizimin e drejperdrejte i te terthorte te qellimit te shoqerise. Shoqeria mund te mbledhi pjesmarrje dhe kuota edhe aksionare ne ndermarrje te tjera ose 2 shoqeri te krijuara ose ne krijim, italiane ose te huaja, qe kane objekt analog te lidhur ose te ngjashem me objektin e saj, por duke mos patur se qellim fi nal vendosjen e saj te te tretet. Per realizimin e objektit shoqeria mund te kryeje, ne rruge ndihmese te gjitha aktivitetet tregtare, industriale, fi nanciare, ato lidhur me te mirat e tundeshme ose te patundeshme (perjashtuar mbledhja e kursimeve) te dobishme dhe/ose te nevojshme, etj.

Neni 5 **Kapitali themeltar**

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte 100'000 (njqindmije) lek i ndare ne 1 (nje) kuote, vlere e te ciles zoterohet nga Ortaku si me poshte:

- **Z. Enea Dervishi**, zoteruese i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te kapitalit me vleren 100'000 (njqindmije) lek.

Neni 6 **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë apo financime ne cash, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin te nenit perkates te statutit, kapitali fillesatar eshte i pataksueshem. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblese se Ortakeve thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej Shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e Shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit ndermjet Ortakeve apo ne persona te trete**

Kuotat e kapitalit të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim e nënshkruar personalisht nga dhe vetëm prej Ortakut perfaqësues apo personit të prokuruar prej tij.

Kuotat për shitje i propozohen me pare repektivisht Ortakeve të Shoqërisë për një afat 30 dite, pas kalimit të këtij afati ato janë lirisht të transferueshme ndaj çdo personi të interesuar.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi vendimmarres i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, vendos dhe përgjigjet për çështje si :

- përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve periodike të ecures së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime, transferime kuotash, etj;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve apo të papublikuara në regjistrin tregtar në QKR, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Mbledhjet e asamblese së Ortakeve

Nëse nuk përcaktohet një vend tjetër, Asambleja e Ortakeve i mban mbledhjet e saj në selinë e Shoqërisë.

Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve do të mbahen jo më pak se 2 (dy) herë në vit, ose mbledhja pasardhëse e Asamblese se Ortakeve do të jetë me një distancë kohore jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga mbledhja paraardhëse.

Çështjet që kërkojnë miratimin e Asamblese se Ortakeve mund të komunikohen me poste të zakonshme apo edhe me poste elektronike (email) dhe keto komunikime janë të vlefshme kur konfirmohen dhe nenshkruhen nga Ortaket, anetare të Asamblese.

Thirrja dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve janë të vlefshme kur procedurat kryhen në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare. Nëse, si rrjedhim i thirrjes së parë të Asamblese, nuk realizohet kuorumi nevojshëm, mbledhja e Asamblese do të shtyhet për një datë të dytë në distancë kohore prej 10 ditësh nga e para dhe, në rast se edhe në këtë mbledhje të dytë mungon vendimmarrja, Ortaket pranojnë vlerësimin e kuotave (cmimin për shitje) brenda një afati prej 7 ditësh dhe me pas ofrojnë kalimin e tyre midis njeri-tjetrit, sikurse është theksuar në Nenin 7 ketu, me një afat brenda 30-ditësh. Pas kalimit të afatit prej 37 ditësh kuotat behen lirisht të transferueshme për shitje kundrejt çdo personi të interesuar për to.

Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblese dhe materialet për diskutim, nisen me poste fizike (poste të zakonshme) ose elektronike, minimumi 7 dite para datës kur do zhvillohet mbledhja e radhës. Kur të gjithë Ortaket janë dakort, mbledhja mund të zhvillohet në çdo datë. Ortaket, me vendim Asambleje, depozitojnë pranë Shoqërisë adresat e postës elektronike ku duan të marrin dhe nga ku do të përgjigjen komunikimeve të Shoqërisë. Ndryshimet e adresës së postës elektronike duhet të komunikohen Administratorit të Shoqërisë me poste fizike, me leter rekomandë ose me poste elektronike dhe deri kur komunikimi për ndryshimin e adresës elektronike nuk ka mbërritur do konsiderohet e vlefshme adresa egzistente në arkivat e Shoqërisë.

Neni 10 **Administrimi**

Emërimi i Administratorit të Shoqërisë është kompetencë e Asamblese se Ortakeve. Administrator i Shoqërisë emërohet për një afat 5 (pese) vjet me të drejtë riemërimi dhe do të jetë ortaku vijues:

1. Z. Enea Dervishi, i datëlindjes 19.05.1995, banuese në Durres, rruga "Asti Gogoli" shtetase shqiptar, madhore dhe me zotësi të plote juridike e për të vepruar, mbajtes i kartës së identitetit nr. 038789436 dhe me nr. Personal J50519013R.

Administratori ka kompetenca, mban përgjegjësi dhe ka për detyrë:

Administratori ka kompetenca e përgjegjësi sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Neni 11 **Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar**

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur Shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit. Në përfundim të çdo viti financiar, administratori përgatit inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin. Po në vijim Administratori dhe konsulentet financiar, që kontraktohen nga

Shoqëria, pasqyrojnë në analize shpenzimet dhe risqet fiskale, planifikojnë buxhetet vjetore dhe i propozojnë Asamblese së Ortakeve politika për të ardhmen e Shoqërisë.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, u kalon Ortakeve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë ose mund të kalojë për investime, por gjithmone bazuar në një vendim të shkruar të Asamblesë së Ortakeve.

Bartja afatgjate e detyrimeve financiare të Shoqërisë kundrejt të tregëve, institucione bankare apo individëve, ndalon Asamblet e Ortakeve në ndarjen e dividendeve me prioritet përmirsimin e gjendjes financiare të Shoqërisë dhe rritje të përgjegjësisë dhe përparsisë për fondet që Shoqëria mobilizon për aktivitetin e saj tregtar kundrejt të tregëve duke i dhënë përparsi ketyre të fundit.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakeve ka të drejtë dhe mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, apo rezervash përveç fondeve të parashikuara këtu.

Neni 12 Baza ligjore

Shoqëria do të zhvilljë aktivitetin në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria **VENTEXUS shpk**

ORTAKU I VETEM:

Z. Enea Dervishi

Enea Dervishi

